



Datë: 10.11.2025
Numër Protokolli: 7259/2025

A.nr.1822/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1822/2025, të datës 21.10.2025 të parashtruar nga ankuesi R.Sh, kundër organit të punësimit: Komunës së Vitisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 05.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1822/2025, e datës 21.10.2025, e parashtruar nga ankuesi R.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesi R.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 21.10.2025, përmes postes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që të kthehet në pozitën e mëparshme Zyrtar i Lartë për Projekte dhe të kompensohet financiarisht për periudhën sa ka qenë i dëmtuar, si dhe korrigjim të koeficientit të pagës në specialist.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.10.2025, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 30.10.2025, ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 6918/2025 të datës 21.10.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën për koeficientin e pagës datës 07.10.2024 nga ankuesin për Zyrën e Personelit; Aktvendimin me numër protokolli 02-013/1607 të datës 12.09.2011; Ankesën për koeficientin e pagës datës 12.09.2023 nga ankuesin për Zyrën e Personelit; Aktvendimin me numër protokolli 03-112/378 të datës 30.01.2009; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin me numër protokolli 03-013/301 të datës 11.03.2011; Akt Emërimit me numër protokolli 06-112-2485 të datës 30.12.2011; Vërtetimin me numër protokolli 02-07/2102 të datës 25.11.2011; Zarfën; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.10.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 30.10.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pasafatshme, **sepse**:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë:

- Ankuesi është i punësuar në Komunën e Vitisë, dhe së i njëjti sipas Aktvendimit me numër protokollit 03-112/378, të datës 30.01.2009 është caktuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Përgatitjen e Projekteve për Tender, pranë Administratës së Personelit.

- Më Vendimin me numër protokollit 03-013/310 të datës 11.03.2011, për ndërrimin e vendit të punës ankuesi ishte caktuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Projekte pranë Zyrës së Prokurimit.

- Sipas Vendimit me numër protokollit 02-013/1607 të datës 12.09.2011, ankuesi është caktuar në pozitën Zyrtar për Projekte, në Drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik, më ç'rast për pozitën e njëjtë më datë 30.12.2011 i është lëshuar Akt Emërimi me numër protokollit 06-112/2485.

- Ankuesi më datë 12.09.2023 i është drejtuar Zyrës së Personelit të Komunës së Vitisë me ankesë për rregullim të koeficientit, duke kërkuar që të kategorizohet si Specialist sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe atë me koeficient 6.52, ankesën e njëjtë e kishte përsëritur po më datë 07.10.2024, mirëpo që në raport më kërkesave e tij sipas thënieve në ankesë nuk ka pranuar përgjigje.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që ndryshimi i pozitës sipas Akt Emërimit me numër protokollit 06-112/2485 të datës 30.12.2011 për pozitën Zyrtar për Projekte është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe pa njoftim paraprak, e që është dëmtuar financiarisht. Shton së ka paraqitur kërkesa tek Zyra e Personelit dhe Kryetari i Komunës, mirëpo nuk ka marrë përgjigje lidhur me korrigjim të koeficientit të pagës në specialist. Kërkon që të kthehet në pozitën Zyrtar i lartë për Projekte, dhe të kompensohet financiarisht për periudhën gjatë të cilës është dëmtuar duke filluar nga data e zbatimit të vendimit deri në rivendosje në pozitën e mëparshme si dhe ti korrigjohet koeficienti i pagës në specialist.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të lëndës dhe pretendimeve ankimore të ankuesit konstaton se sipas Vendimit me numër protokollit 02-013/1607 të datës 12.09.2011 për ndërrim të vendit të punës, ankuesi nga pozita e Zyrtarit të Lartë për Projekte në kuadër të Zyrës së Prokurimit, Administratës dhe Personelit ishte caktuar në pozitën Zyrtar për Projekt, në Departamentin e për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik dhe për këtë pozitë më datë 30.12.2011 i është lëshuar Akt Emërimit me numër protokollit 06-112/2485, të cilën akt ankuesi e kishte nënshkruar po më datë 30.12.2011, pa ndonjë vërejtje, rrjedhimisht ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi se i njëjti e kishte kontestuar me mjete juridike Vendimin me numër protokollit 02-013/1607 të datës 12.09.2011 apo aktin e emërimi me numër protokollit 06-112/2485.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për kundërligjshmërinë e Akt Emërimit me numër protokollit 06-112/2485 të datës 30.12.2011, Kolegji i Këshillit rikujton legjislacionin e aplikueshëm në atë kohë gjegjësisht:

Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, i cili më nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 81 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar se: Neni 50, "1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike. Neni 81.

1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku më nenin 4 paragrafi 1, parashihej se: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”, Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, ku më nenin 130 paragrafi 130.1 pika b ka përcaktuar: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi,

Andaj, në kontekst të kuadrit ligjor si më lart, Kolegji i Këshillit konstaton së ankesa lidhur me kundërligjshmërinë e Akt Emërimit me numër protokolli 06-112/2485 të datës 30.12.2011, është e parashtruar në kundërshtim me afatet e përcaktuar me dispozitat e cekura më lartë, dhe si e tillë ankesa lidhur me këtë pretendim është e jashtë afatshme, në kuptim të nenit 130 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.

Përkitazi më pretendimin ankimor për klasifikim të koeficient të pagës si specialist, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi shkresave të lëndës ka gjetur së ankuesi fillimisht më datë 12.09.2023 dhe me pastaj datë 07.10.2024 i është drejtuar Zyrës së Personelit të Komunës së Vitisë me ankesë duke kërkuar që të kategorizohet si Specialist sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe atë me koeficient 6.52, dhe së sipas thënieve në ankesë dhe shkresave të lëndës të dorëzuar nga organi i punësimit nuk vërtetohet së ankuesi kishte marr përgjigje nga institucioni lidhur me ankesat e tij.

Ne kuptim të pranueshëmrisë së ankesë lidhur me pretendimin e ankueist për kategorizim të pagës në specialist, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me theks të veçantë nenit 98, paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.....nenit 124 paragrafit 1 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe : 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ dhe si rrjedhojë duke bazuar në këtë përcaktim ligjor rezulton së ankuesi nuk ka pranuar përgjigje në kërkesat e tij brenda fatit prej 45 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës atëherë ankuesi pas afatit prej 7 ditësh nga skadimi i afatit 45 ditor, por jo më shumë së dy (2) muaj nga data kur organi punëdhënës duhej të ofronte përgjigje në kërkesat veç e veç, ka pas tw drejtën e ushtrimit të ankesës në KPMSHCK për shkak të heshtjes administrative.*

Andaj, mbi këto rrethana, ankesa e ushtruar më datë 21.10.2024, lidhur me pretimin për kategorizim të pagës në specialist, është po ashtu e jashtë afatshme në kuptim të nenit 127, paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.1822/2024, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankuesit që i njëjti serish të parashtojë kërkesë tek organi punëdhënës për klasifikim të pagës në specialist, e në rast të heshtjes së serishme administrative të këtij të fundit, ankuesi mund të ushtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1822/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit R.Sh;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.